



PASAPORTA

E TË DREJTAVE TË MIA





PASAPORTA

E TË DREJTAVE TË MIA



Për informacione ose komente mund të drejtoheni tek:

**CEDI - QENDRA PER
ZHVILLIM DHE INTEGRIM
EUROPIAN**

Rr. Asim Zeneli (4.15 mi)
Tiranë, Shqipëri
Tel: + 355 69 52 88 494
qendra.cedi@gmail.com

**KONRAD-ADENAUER-STIFTUNG E.V.
RULE OF LAW PROGRAMME
SOUTHEAST EUROPE**

Franzelarilor Street 5, Sector 2
RO-020785 Bucharest
Romania
tel:+40 21 302 02 63
<https://www.kas.de/en/web/rlpsee>

Përgatiti: Dr. Heliona Miço & MSc. Klara Kodra

Botues:

ISBN:

Desing & Layout: Dritan Lleshi

Ilustrimet: Freepik.com

PËRMBAJTJA

A e dini se?	5
Pasaporta ime - Kush jam unë?	6

Kapitulli I

Si kanë lindur dhe evoluar të drejtat e fëmijëve?!	7
1.1 Evoluimi i të drejtave dhe lirive në këndvështrimin ndërkombëtar dhe kombëtar.....	9

Kapitulli II

Të eksplorojmë të drejtat dhe liritë tona	13
2.1 Puzzle 1 - Të zhvillojmë potencialin tonë.....	14
2.2 Puzzle 2 - Të kemi një jetesë më të mirë dhe të ndjehemi të mbrojtur.....	19
2.3 Puzzle 3 - Roli ynë në shoqëri.....	21

Kapitulli III

Pjesëmarrja e fëmijëve në familje shkollë dhe më gjerë	25
3.1 Ti dhe familja.....	26
3.3 Ti dhe vendi yt.....	32

Kapitulli IV

Unë kërkoj dhe mbroj të drejtat e mia	37
4.1 Çfarë ndodh nëse të drejtat dhe liritë e mia nuk respektohen?.....	38
4.2 Ti ke të gjitha mundësitë për të mbrojtur veten tënde dhe shokët.....	44
Bibliografi	46



A E DINI SE?

- ★ Fëmijë është çdo person nën moshën 18 vjeç.
- ★ 20 nëntori njihet si dita botërore e fëmijëve.
- ★ Organizata ndërkombëtare e të drejtave të fëmijëve është Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (UNICEF).
- ★ Në 1973 u vendos se mosha minimale për të punuar është 18 vjeç.
- ★ Viti 1979 është shpallur si viti ndërkombëtar i fëmijëve nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB).
- ★ Selia e OKB ndodhet në qytetin e New York.
- ★ Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës u miratua në 1989.
- ★ Shqipëria ka ratifikuar Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës në 1992.

PASAPORTA IME - KUSH JAM UNË?

Emër:

Mbiemër:

Atësia:

Shtetësia:

Gjuha:

Shkollimi:

Hobi:

Adresa:



FOTO



KAPITULLI I

SI KANË LINDUR DHE EVOLUAR TË DREJTAT E FËMIJËVE?!

Në 20 nëntor të vitit 1989, Asambleja e Kombeve të Bashkuara, miratoi “Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës”, e cila është një dokument zyrtar ku parashikohen të drejtat shoqërore, kulturore, ekonomike dhe politike të fëmijëve. Gjithashtu, ky dokument u vjen në ndihmë qeverive të vendeve që e kanë firmosur atë, sesi të ndjekin hapat e duhura për ti bërë të gjithë fëmijët anë e mbanë botës sa më të sigurt dhe sa më të lumtur. Por, para hartimit të këtij dokumenti keni kuriozitet të dini se çfarë ka ndodhur.

Le të fillojmë të plotësojmë një puzzle magjik së bashku, duke gërmuar pakëz përmes historisë.



Në shekullin e XIX, zënë fill të drejtat e fëmijëve, kur për herë të parë u panë si qenie që kishin nevojë për mbrojtje dhe ata duhej të arsimoheshin dhe jo të punonin



1.1 EVOLUIMI I TË DREJTAVE DHE LIRIVE NË KËNDVËSHTRIMIN NDËRKOMBËTAR DHE KOMBËTAR

- ❖ Do të kthehemi pas në kohë, në *periudhën e lashtësisë*, atëherë kur fëmijët silleshin dhe punonin sikurse të rriturit dhe pronë e prindërve.
- ❖ Më tej, *në të drejtën romake*, babai ishte i plotfuqishëm dhe i takonte atij të vendoste mbi të drejtën e tyre për të jetuar ose jo.
- ❖ *Edhe në mesjetë*, situata e fëmijëve nuk ndryshoi shumë. Ata mund të bliheshin dhe shiteshin si mallra. Ishin shumë të rrallë fëmijët që mund të arsimoheshin dhe kryesisht me orientim fetar.
- ❖ *Në periudhën e rilindjes*, që njihet si periudha e revolucionit arsimor, fëmijët anë e mbanë botës ende nuk gëzonin të drejta.
- ❖ *Në shekullin e XVII*, babai vijonte të kishte statusin e të plotfuqishmit dhe vendoste për fatin e fëmijës së tij.
- ❖ *Në shekullin e XVIII*, fëmijëria ishte ende një periudhë shumë e shkurtër. Edhe pse të mitur, fëmijët shkonin në luftë ose punonin. Gjatë këtij shekulli fëmijët u konsideruan si qenie me vlera,

që kanë nevojë për kujdes të veçantë dhe u bë dallimi gjinor mes vajzave dhe djemve.

- ❖ *Në shekullin e XIX*, zënë fill të drejtat e fëmijëve, kur për herë të parë u panë si qenie që kishin nevojë për mbrojtje dhe ata duhej të arsimoheshin dhe jo të punonin. Për këtë u miratuan dhe zbatuan ligje të ndryshme në mbarë Evropën, ku pak e nga pak shoqëritë e këtyre vendeve filluan të ndërgjegjësoheshin dhe kuptonin se fëmijët nuk mund të trajtohen si të rriturit. Pragu i moshës minimale për punë u rrit nga 6 vjeç në 16 vjeç.
- ❖ *Shekulli i XX*, pati një hov të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. *Deklarata e Gjenevës* shpalohej të drejtën për t'u zhvilluar; lirinë ekonomike, mbrojtjen nga shfrytëzimi si dhe edukimin dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë. Më pas, në Deklaratën e të Drejtave të Fëmijëve parashikohej e drejta për t'u arsimuar, argëtuar dhe kujdes shëndetësor. Në këto hapa vijoi promovimi i interesave të fëmijëve në vazhdimësi. Përpjekjet vijuan për parandalimin e kriminalitetit si dhe eliminimin e të gjitha formave të punësimit që ndikonin negativisht në shëndetin, sigurinë dhe moralin e fëmijëve.

- ❖ *Në shekullin që po jetojmë (XXI)* janë shtuar përpjekjet për zbatimin e duhur të të drejtave dhe lirive të fëmijëve. Me vëmendje të veçantë janë duke u trajtuar rastet e shfrytëzimit dhe abuzimit të të miturve si dhe fëmijët që jetojnë në vendet në situatë lufte.
- ❖ Një nga aktet e para ndërkombëtare të firmosura nga Shqipëria pas rënies së sistemit komunist, është *Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës*. Vendi ynë u angazhua në mbrojtje të të drejtave nga viti **1992**, në mënyrë që fëmijët shqiptarë të gëzojnë dhe ushtrojnë plotësisht të drejta që kanë të bëjnë me kushtet ekonomike, shoqërore, ligjore dhe institucionale. Koncepti i mbrojtjes së fëmijës është relativisht i ri për Shqipërinë. Që të drejtat e tua të realizohen plotësisht, kërkohen jo vetëm nisma ligjore, por ndërgjegjësim i organeve shtetërore e shoqërore dhe në veçanti ndërgjegjësim juaj për të njohur dhe kërkuar zbatimin e të drejtave tuaja.

“

Në rast se duam të luajmë një rol të rëndësishëm në shoqëri, madje të lëmë gjurmën tonë duhet të përpiqemi që të arrijmë atë çfarë dëshirojmë të bëhemi në jetë





KAPITULLI II

TË EKSPLOROJMË TË DREJTAT DHE LIRITË TONA

Patjetër që ju është thënë se nuk duhet të dëmtoni sendet që ju përkasin të tjerëve, nuk duhet të gënjeni, nuk duhet të ziheni apo të vidhni gjërat e shokëve tuaj. Duhet të jeni qytetarë të devotshëm, të mësoni në shkollë, të ndihmoni shokët, të dëgjoni prindërit dhe mësuesit. Por a e dini se ju **keni shumë të drejta dhe liri**? Për këtë, së bashku do vijojmë aventurën për të plotësuar puzzle-in e të drejtave dhe lirive tuaja. Ju e vërejtët vetë sesa të vështirë e kanë pasur jetesën fëmijët, sesa pak të drejta dhe liri kanë gëzuar në të kaluarën, por nga viti '89 "Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës"

ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në njohjen dhe respektimin e tyre. Për ta pasur pak më të thjeshtë e për të mbajtur mend të drejtat tona, po bëjmë një grupim të tyre. Mbani në vëmendje, **sa më tepër pjesë të puzzel-it të vendosim ku duhet, aq më tepër do të dimë të mbrojmë veten tonë kur personat e tjerë nuk i respektojnë këto të drejta, por gjithashtu mund t'ju vijmë në ndihmë shokëve dhe shoqeve tona.**

2.1 PUZZLE 1 - TË ZHVILLOJMË POTENCIALIN TONË

- ❖ *Regjistrimi sapo lind* është një nga të drejtat kryesore të fëmijës. Kjo lidhet me *identitetin* e tij/saj, përfshi me emrin, mbiemrin, të drejtën për të njohur prindërit, për të pasur kujdesin e tyre apo për të njohur lidhjet familjare. Por, ndodh që ndonjëherë të drejtat e mësipërme të mos sigurohen. Këtu shteti luan rolin rregullator në zbatimin ose vendosjen e në vend të këtyre të drejtave.
- ❖ Nga ana tjetër, ju të gjithë jeni pjesë e një familje, e një bashkësie ose institucioni përgjegjës për fëmijët. Prindërit, kujdestarët, personat që kujdesen për ju, ju mësojnë të zhvilloni aftësitë

tuaja. Për t'ju ardhur në ndihmë ata kanë disa përgjegjësi dhe të drejta që i ushtrojnë për t'ju udhëhequr në rrugën e jetës. Ndonjëherë ndodh që t'ju kritikojnë, t'ju shkulin edhe veshin, t'ju lavdërojnë por edhe të krenohen me ju. Të gjitha këto përbëjnë atë që ne e hasim me termin *të drejtat prindërore*.

- ❖ Ju keni të drejtë të *mbani marrëdhënie individuale dhe të rregullta me prindërit* që banojnë në shtete të ndryshme, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme (rastin e luftërave, fatkeqësive natyrore).
- ❖ Nga ana tjetër shteti respekton të *drejtën e fëmijës dhe të prindërve të tij për t'u larguar nga çdo vend*, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehen në vendin e tyre. Ka disa raste kur e drejta për t'u larguar nga vendi mund të kufizohet, siç janë mbrojtja e sigurisë kombëtare, rendit publik, shëndetit etj. Ribashkimi i familjes, duhet të trajtohet me humanizëm dhe sa më shpejt, për të mos sjellë pasoja të dëmshme për familjen.
- ❖ Në rast se duam të luajmë një rol të rëndësishëm në shoqëri, madje të lëmë gjurmën tonë duhet të përpiqemi që të arrijmë atë çfarë dëshirojmë

të bëhemi në jetë. Arma më e fortë që mund të ndihmojë në zhvillimin tonë është *arsimimi*. Zhdukja e padijes dhe analfabetizmit janë shumë të rëndësishme në shoqëritë demokratike. Për këtë në dokumente ndërkombëtare dhe kombëtare *arsimi fillor është i detyrueshëm dhe falas*. Madje dhe me tej, shteti duhet të bëjë përpjekje për inkurajimin dhe frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e numrit të nxënësve që e braktisin atë. Në rast se largohesh nga shkolla, mundësitë janë më të larta që të abuzosh me lirinë tënde, duke mësuar vese, duke e bërë më të thjeshtë rekrutimin nga grupet kriminale, ekstremistë apo të bëheni pre e trafikimit. Pra, *arsimimi ndihmon në formimin e personalitetit, dhuntive që mund të kesh në jetë apo aftësive mendore dhe fizike*. Të ndihmon një njohësh identitetin, gjuhën dhe vlerat e tua kulturore e kombëtare. Të bën më të përgjegjshëm, të jesh më mirëkuptues, të zhvillosh diskutimin, të kesh ndjenjën e tolerimit, barazisë gjinore, të krijosh miqësi të njohësh persona të etnive apo besimeve të ndryshme. Askund nuk mund të arrish të njohësh dhe mësosh kaq shumë gjera veçse në një komunitet siç është shkolla.

- ❖ Juve ju ka rastisur që në klasë, lagje, komunitet të njihni *fëmijë që janë me aftësi ndryshe*. Edhe ata si të gjithë bashkëmoshatarët e tyre duhet të bëjnë një jetesë normale, të përshtatshme, me dinjitet, të jenë të pavarur dhe të jenë aktivë në jetën shoqërore. Sigurisht që këta fëmijë *kanë nevojë për një kujdes më të posaçëm*, por gjithashtu kanë nevojë *për mbështetjen tuaj* dhe të ndjehen të pranuar. Ashtu si çdo fëmijë ata duhet të kenë mundësi të arsimohen, kualifikohen, përfitojnë shërbime shëndetësore, riaftësimi, përgatitje për punësim dhe veprimtari argëtuese, në mënyrë që të integrohen në shoqëri.
- ❖ Gjithashtu, të gjithëve na rastis që të kemi shokë dhe shoqe që i përkasin *pakicave etnike, fetare apo gjuhësore*, ose personave që i përkasin një minoriteti. Askujt nuk mund t'i mohohet *e drejta për të pasur kulturën e vet*, për të ushtruar dhe *praktikuar fenë* e vet, ose për të *përdorur gjuhën* e vet së bashku me anëtarët e tjerë të grupit. Bukuria e jetës qëndron tek larmishmëria dhe të kuptuarit që të gjithë *jemi të ndryshëm*.

“

Për të luajtur rolin tënd në shoqëri, do të thotë që ti mund të jesh i aftë që të bëhesh pjesë e proceseve vendimmarrëse, duke filluar nga familja, shkolla dhe akoma më gjerë



2.2 PUZZLE 2 - TË KEMI NJË JETESË MË TË MIRË DHE TË NDJEHEMI TË MBROJTUR

Ti ke të drejtë:

- ❖ *Për të jetuar* dhe për këtë familja dhe më gjerë shteti duhet të marrë të gjitha masat për të siguruar jetesën dhe zhvillimin tënd. *Prindërit kanë përgjegjësi* për edukimin dhe aftësimin tënd. Ti ke të drejtë të jesh i mirë ushqyer, të kesh ujë të pijshëm, të kesh një banesë dhe një higjienë të pastër si dhe të gëzosh shëndet të plotë dhe kur është e nevojshme të marrësh kujdesin e duhur shëndetësor.
- ❖ Të kesh një nivel të ardhurash familjare të mjaftueshme me qëllim për të pasur një zhvillim fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror të ekuilibruar. Në rastet kur kushtet ekonomike në familje janë të vështira ti ke të drejtë të përfitosh *përkrahje shoqërore*.
- ❖ Të *pushosh dhe të argëtohesh*, të praktikosh lojëra dhe veprimtari çlodhëse të cilat janë të përshtatshme për moshën tënde. Gjithashtu, pjesëmarrja në veprimtari kulturore dhe artistike zhvillon mjaft imagjinatën por dhe inteligjencën tënde emocionale.

- ❖ Që interesat e tua të respektohen *pa asnjë lloj dallimi* që lidhen me racën, ngjyrën e lëkurës, gjininë, gjuhën, fenë, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare.
- ❖ *Të mbrohesh nga çdo formë abuzimi*, qoftë dhunë fizike apo mendore fyerje ose keqtrajtim, braktisje apo mospërfillje, nëpërkëmbje ose shfrytëzim, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që je nën kujdesin e prindërve ose të përfaqësuesit ligjor ose çdo personi tjetër që i je besuar.
- ❖ Të mos punosh nëse nuk ke arritur moshën për të punuar. Në Shqipëri mosha minimale për t'u pranuar në punë është 16 vjeç, por për punë të lehta dhe me një orar të kufizuar. Gjithashtu, ka disa raste përjashtimore për 15 vjeçarët ose për moshat nën 14 vjeç, të cilët mund të angazhohen në aktivitete kulturore ose artistike. **Kujdes** duhet bërë një dallim ndërmjet shfrytëzimit për arsye ekonomike, siç mund të jenë rastet kur juve ju cenohet e drejta për t'u edukuar, ose puna që detyroheni të bëni dëmton shëndetin apo zhvillimin tuaj fizik, mendor, shpirtëror, moral ose

shoqëror. Nga ana tjetër, gjithsecili prej jush duhet të mësohet me kulturën e punës. Të rregullojë dhomën e tij/saj, të bëjë pazaret, të hedhë plehrat, të ndihmojë vëllezërit/motrat më të vegjël për detyrat e shtëpisë, të ndihmojë prindërit për detyra të vogla që mund t'ju ngarkohen.

2.3 PUZZLE 3 - ROLI YNË NË SHOQËRI

- ❖ Për të luajtur rolin tënd në shoqëri, do të thotë që ti mund të jesh i aftë që *të bëhesh pjesë e proceseve vendimmarrëse*, duke filluar nga familja, shkolla dhe akoma më gjerë. Ndërkohë është shumë e rëndësishme që *zëri dhe nevojat e tua duhet të dëgjohen* sa herë që merret një vendim për ty, duke u mbajtur në vëmendje interesi yt më i lartë.
- ❖ Gjithashtu, në raport me moshën dhe pjekurinë mund ti mund *të shprehësh lirisht mendimet* për çështje vetjake. P.sh., në rastet gjyqësore ose administrative ty të jepet mundësia për të dhënë mendim me cilin prind që dëshiron të jetosh. Edhe nëse duhet të rrish vetëm më njërin prej tyre, ti duhet të kesh mundësinë të takosh prindin tjetër rregullisht. Rast përjashtimor është kur kjo nuk është në interesin tënd.

- ❖ Ti po ashtu ke *të drejtën për t'u shprehur lirisht*, për të kërkuar një arsimim më të mirë, për të kërkuar që ambienti apo tualetet e shkollës të jenë më të pastra, për të shkëmbyer informacion dhe ide përmes komunikimit me gojë ose shkrim, në mënyrë artistike, si përmes pikturës, këngës, teatrit etj. Patjetër që ka disa kufizime që duhen respektuar kur lidhen me të drejtat apo reputacionin e të tjerëve ose në rastet e sigurisë kombëtare.
- ❖ *Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar*, është një formë e pjesëmarrjes në jetën shoqërore. Çdokush e gëzon këtë të drejtë, por ka dhe disa parashikime ligjore kufizuese, që janë të nevojshme për mbrojtjen e rendit publik, moralit, të drejtave dhe lirive të të tjerëve.
- ❖ Ju keni *të drejtë të organizoheni në grumbullime paqësore* duke kërkuar që të drejtat tuaja të respektohen. Cilat mund të jenë disa nga këto të drejta? Një ambient më i pastër në shkollë apo në qytet. Krijimi i një këndi lojërash në lagjen tuaj apo krijimi i hapësirave sportive. Një bibliotekë më e pasur për shkollën apo qytetin tuaj. Më shumë organizime edukative për ju. Janë kaq e kaq gjëra që ju mund ngrini zërin tuaj dhe bëheni pjesë e proceseve vendimmarrëse.

- ❖ *Mbrojtja e privatësisë* është mjaft e rëndësishme për moralin dhe dinjitetin tuaj. Shpesh, na ndodh të hedhim disa mendime në letër në atë që e quajmë ditar, apo hapësirën tonë personale ku kemi dëshirë të mbajmë shënim shprehje të bukura, këngë, të pikturojmë, të ngjisim figura apo ndonjë kartolinë nga një shok/shoqe. A nuk ju cenohet hapësira personale kur dikush e merr pa lejen tuaj bllokun, apo lexon kartolinat që shkëmbeni me njëri-tjetrin? **Por, kujdes!** Jo çdo lloj kontrolli lidhet domosdoshmërisht me cenimin e privatësisë, pasi për shkak të moshës suaj, shpesh duhet pasur kujdes me teknologjinë dhe kanalet të cilat hapni. Këtu kalojmë në diçka tjetër që është e lidhur me sigurinë tuaj personale.



Ti duhet të dëgjohesh në përputhje me moshën dhe aftësinë tënde për të kuptuar. Në varësi të moshës ti mund të vendosësh për të menaxhuar kursimet e tua





KAPITULLI III

PJESËMARRJA E FËMIJËVE NË FAMILJE SHKOLLË DHE MË GJERË

Në një shoqëri demokratike, fuqia i takon të gjithë qytetarëve. Ata zgjedhin se cili do të jetë përfaqësuesi i tyre në zgjedhje. Demokracia ushtrohet kudo, në familje, në qytet, në fshat ose edhe në klasë. Në këtë mënyrë të gjithë mund të marrim pjesë në procese demokratike. Pjesëmarrja fillon që tek familja, kur zëri yt duhet të dëgjohet, vijon me shkollën ku mund të angazhohesh dhe në një grupim më të madh siç është qeveria e nxënësve dhe më gjerë, ti mund të gjendesh përballë institucioneve lokale ose qendrore për të kërkuar respektimin e të drejtave të tua.

3.1 TI DHE FAMILJA

Eksperienca jote e parë për t'u bërë pjesë e proceseve vendimmarrëse nis në familje. A e keni vënë re se ndonjëherë flitet për ju në praninë tuaj, sikur të mos ishit aty dhe në këtë mënyrë merren vendime po për ju. Këtu është mjaft e rëndësishme që ti të vendosësh në praktikë mësimin që nxore në **Puzzle 3** që lidhet me të drejtën tënde për pjesëmarrje.

Ti duhet të *dëgjohesh në përputhje me moshën dhe aftësinë tënde për të kuptuar*. Në varësi të moshës ti mund të vendosësh për të menaxhuar kursimet e tua. Të gjithë e kemi nga një derrkuc ose portofol simbolik dhe na ndodh të themi, që do blej një libër me lekët e mia, apo do blej një telefon me lekët që mu mblodhën për ditëlindje. Ky është një vendim që ti je duke marrë për veten.

Gjithashtu, ty të takon të përcaktosh vendbanimin apo se me cilin prej prindërve do të qëndrosh në rast se ata kanë vendosur të ndahen. Kjo është një situatë që mund të të vendosë përballë një vendimmarrje të vështirë, por ti e di dhe ndjen se cili do të ishte interesi yt më i lartë. Për këtë të kërkohet të bisedosh edhe me një psikolog, i cili të ndihmon që vendimmarrja jote të jetë sa më e thjeshtë.

Një nga detyrat kryesore të familjes është sigurimi i mirëqenies tënde emocionale, të rritesh në një ambient

të qetë, në harmoni, të mirë ushqehesh, të kesh për t'u veshur, të mund të edukohesh dhe arsimohesh dhe të mund të argëtohesh. Këto duhet të jenë në harmoni me prirjet dhe dëshirat e tua natyrore.

Nga ana tjetër prindi ka për detyrë t'ju informojë, drejtojë dhe udhëzojë lidhur me sfidat jetësore, por gjithnjë duke u përpjekur që të krijojë një urë komunikimi të tillë që ju të mund të shprehni lirshëm mendimin tuaj dhe të ndjeni se ajo çfarë thoni mund të merret parasysh dhe vlerësohet nga ana e prindërve. Që ti japim kuptim gjithë sa folëm më sipër mund të shprehim veten tonë përmes disa pyetjeve shumë të thjeshta në dukje. *Hëm...*

- ★ **Kush jam unë sot?**
- ★ **Çfarë dëshiroj të bëhem kur të rritem?**
- ★ **Imagjino dhe përshkruaj si do të jesh ti në vitin 2030?**


Në vitin 2030 unë:

.....

.....

.....

.....

Shpreh imagjinatën tënde përmes artit

3.2 TI DHE SHKOLLA

Shkolla është institucioni bazë për formimin tënd. Aty nis organizimi i parë në grupe të vogla dhe e merren vendimet e para në komunitet që ndikojnë përditshmërinë e gjithsecilit. Ti mund të organizohesh me një shok ose shoqe për një detyrë shkollore, për pastrimin ose organizimin e këndit të klasës, për zbukurimin e ambientit ku qëndroni, për festa apo ditëlindje.

Por krijimi i një grupi në shkollë mund të jetë akoma më i madh dhe më i strukturuar, siç është *Qeveria e Nxënësve*. Këto organizime janë tepër të rëndësishme pasi promovojnë frymën e edukimit, bashkëpunimit dhe këshillimit mes bashkëmoshatarëve dhe realizojnë të drejtat që renditëm së bashku. A e dini se ju keni mundësi të shprehni mendimet tuaja individuale ose kolektive që mund të ndikojnë në hartimin e kurrikulave, planifikimin apo organizimin e orës së mësimit apo disiplinës?! Në rast se ti vëren se diçka nuk shkon siç duhet mund paraqesësh, kërkesë/ ankesë pranë Qeverisë së Nxënësve, pranë drejtorit të shkollës, mësuesit, psikologut apo punonjësit social.

Kërkesat që paraqiten *në mënyrë kolektive* mund të kenë të bëjnë me problematika që lidhen me

ambientin e pastër të shkollës, shfrytëzimin e laboratorëve, bibliotekës, salla e kompjuterëve, me hapësirën sportive dhe çlodhëse të shkollës apo me organizimet e aktiviteteve kulturore, edukative, artistike, shkencore dhe sportive jashtë shkollore.

Nga ana tjetër ti mund të paraqesësh *kërkesa/ankesa individuale* tek drejtori i shkollës kundrejt një vlerësimi të ulët që ju është dhënë nga mësuesi, kundrejt një liste notash tek sekretarja, të informohesh për bursën që të është ofruar, apo ti drejtohesh psikologut/punonjësit social për një problem individual që të shqetëson. Të gjitha këto që parashtriam më sipër janë shprehje e pjesëmarrjes në proceset vendimmarrëse.

Në rast se ti je pre e sjelljeve të dhunshme në shkollë, ke të drejtë të ankohesh pranë mësuesit kujdestar apo psikologut të shkollës të cilët ia paraqesin çështjen drejtorit të shkollës, i cili ja paraqet rastin Komisionit të Etikës dhe të Sjelljes së institucionit arsimor. Në rast se sjellja e dhunshme përbën vepër penale, ajo i kalon për shqyrtim policisë së shtetit.

Pra, shkolla është institucioni më i mirë ku ty të jepet mundësia të njihesh me të drejtat e tua, të marrësh përsipër përgjegjësi si dhe të bëhesh pjesë e jetës kulturore, artistike, veprimtarive shkencore, argëtuese

3.3 TI DHE VENDI YT

Shteti yt duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që ti të kesh mundësi të ushtrosh të gjitha të drejtat dhe liritë e tua. P.sh. një nga të drejtat që duhet të të garantohet nga shteti është *mbrojtja e shëndetit*. Pra, ty duhet të të ofrohet ndihma dhe kujdesi i nevojshëm mjekësor. Kjo arrihet përmes sigurimit të kontrolleve që i bëhen ushqimeve, ujit të pijshëm, mbajtjes pastër së mjedisit, ndërtimit të spitaleve etj.

Gjithashtu, shteti duhet të sigurojë *përkrahje shoqërore*, kur të ardhurat e tua familjare janë të ulta. Një nivel jetese i mjaftueshëm është i rëndësishëm për zhvillimin tënd fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror. Përgjegjësia për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës i takon prindërve ose personave të tjerë përgjegjës, por nëse kjo nuk është e mundur shteti duhet të marrë masat e nevojshme. Një nga këto masa është *hartimi i programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijëve* dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, duke i përfshirë, nëse lind nevoja në proceset gjyqësore.

Ty mund të të sigurohet përkujdesje alternative, si *birësimi* ose në rast nevojë, vendosja në një qendër të përshtatshme të kujdesit për fëmijët, por duke u mbajtur në vëmendje dëshira për vazhdimësinë në edukimin tënd, origjina etnike, fetare, kulturore dhe gjuhësore.

Në raste të *abuzimit fizik apo emocional* vendi yt duhet të marrë të gjitha masat dhe të të vijë në ndihmë përmes institucioneve, qendrave dhe shërbimeve të kujdesit për fëmijët ose dhe personave të specializuar siç janë psikologët, punonjësit socialë, qendrat e argëtimit për të lehtësuar rikthimin dhe ri integrimin në jetën normale.

Ty *nuk duhet të të hiqet liria* në mënyrë të paligjshme ose arbitrare. Nëse ndodh kjo gjë, atëherë ti ke të drejtë të marrësh menjëherë ndihmë juridike si dhe të trajtohesh sipas nevojave specifike të moshës dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të vendosesh në të njëjtin ambient me të rritur.

Ti *nuk duhet ti nënshtrohesh torturës*, as trajtimeve ose dënimeve çnjerëzore ose poshtëruese. Gjithashtu, dënimi me vdekje dhe burgimi i përjetshëm nuk mund të jepen për asnjë një fëmijë.

Në rast se ndodhesh në një shtet tjetër dhe kërkon *azil* qoftë nëse je vetëm apo i shoqëruar nga prindërit ose nga çdo person tjetër, duhet të përfitosh nga mbrojtja dhe përkrahja humanitare e duhur. Në rastet se ndodhesh vetëm, ty duhet të të jepet e njëjta mbrojtje, si çdo fëmije tjetër që i ka munguar gjithnjë ose përkohësisht mjedisi familjar. Në situatë lufte ti duhet të mbrohesh nga vendi yt si dhe nëse nuk ke mbushur 15 vjeç nuk mund të rekrutohesh në ushtri.

***Imagjino dhe përshkruaj cili
do të ishte vendi ideal për fëmijët.***

Vendi ideal për mua do të ishte:

.....

.....

.....

.....

.....


.....

.....

.....

.....

Pikturo vendin ideal për fëmijët





Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është dokumenti themeltar i shtetit ku gjenden të parashikuara të drejtat tuaja





KAPITULLI IV

UNË KËRKOJ DHE MBROJ TË DREJTAT E MIA

Në mënyrë që të respektohet demokracia dhe bashkëjetesa në komunitet të jetë në harmoni, ti si një qytetar i këtij vendi ke arritur të njohësh disa nga të drejtat dhe liritë e tua dhe njëherësh kë marrë përsipër përgjegjësitë për veprimet e tua duke pranuar që të gjithë rreth nesh janë të ndryshëm. Për këtë një sërë instrumentesh kombëtare dhe ndërkombëtare ju vijnë në ndihmë për të aplikuar gjithë parimet e rëndësishme që mësuam. Pak nga pak puzzle ynë po merr formën përfundimtare, por përpara se ta vendosim në një kornizë na duhet të mësojmë dhe diçka të fundit.

4.1 ÇFARË NDODH NËSE TË DREJTAT DHE LIRITË E MIA NUK RESPEKTOHEN?

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është dokumenti themeltar i shtetit ku gjenden të parashikuara të drejtat tuaja. Kushtetuta garanton një sërë të drejtash jo vetëm ty që je shtetas shqiptar por edhe fëmijëve me qëndrim të përkohshëm si dhe vizitorëve në vendin tonë. Ti hedhim një sy këtyre të drejtave.

❖ *Kushtetuta garanton:*

- » Mbrojtjen e veçantë nga shteti N. 54
- » Të drejtën për të mos u diskriminuar N.18
- » Të drejtën e jetës N. 21
- » Mos diskriminimi i fëmijës N 54 § 2
- » Mbrojtja nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë N 54 § 3
- » E drejta për arsim N. 57
- » Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar N. 24
- » E drejta e informimit N. 22;
- » E drejta e organizimit N. 46
- » E drejta për të pasur kujdes shëndetësor N. 55

❖ *Kodi Civil dhe Kodi i Procedurës Civile mbron:*

- » Të drejta pasurore të fituara nëpërmjet trashëgimisë N. 320

- » Të drejtën e emrit N. 5
- » Të drejtën e vendbanimit N. 13
- » Të drejtën për t'u pyetur para organeve administrative dhe gjyqësore
- ❖ *Ligji "Për Shtetësinë"* Fitimin e shtetësisë
- ❖ *Kodi i Punës* Të drejtën e mbrojtjes në punë
- ❖ *Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale* mbron të drejtat dhe lehtësitë në fushën penale të parashikuara në nenet e tyre. Megjithatë, njohja e të drejtave të fëmijëve nuk ndalet me kaq.
- ❖ *Ligji për të drejtat e fëmijës* konfirmon të drejtat e tyre, por dhe ju tregon organizmave shtetërore dhe shoqërore e më gjerë komunitetit që pavarësisht se ju jeni fëmijë, ju lindni me një sërë të drejtash për të cilat shteti duhet të marrë të gjitha masat që t'i gëzoni.

Për t'ju ardhur në ndihmë që të drejtat e mësipërme t'ju garantohen një makineri e tërë mekanizmesh punon për mbrojtjen e tyre. Ti vërejmë së bashku organet qendrore:

- ❖ *Ministria* që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës,
- ❖ *Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës* dhe
- ❖ *Ministrinë e ndryshme* sipas fushave që mbulojnë.

Organet në nivel lokal:

- ❖ *Bashkia;*
- ❖ *Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore* në bashki;
- ❖ *Njësia për mbrojtjen e fëmijës (NJMF)* në bashki;
- ❖ *Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit* pranë bashkisë ose njësive administrative;
- ❖ *Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës* pranë NJMF dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

Pasi u njohëm me ligjet dhe organizatat e vendit tonë do hedhim pak vështrimin në arenën ndërkombëtare dhe konkretisht marrëveshjet që ka vendi ynë me botën e madhe. Mbani në vëmendje, nëse të drejtat e fëmijëve shkelen në nivel kombëtar dhe nuk gjejnë zgjidhje brenda vendit tonë, ju mund të kërkonti dëmshpërblim në nivelin ndërkombëtar.

Ashtu siç ka ligje të brendshme që garantojnë të drejtat tuaja ekzistojnë edhe instrumente ndërkombëtare siç janë Konventat. Këto dokumente janë marrëveshjeve mes shteteve, që vendosin të drejta dhe detyrime mes tyre, por gjithashtu i inkurajojnë vendet që i kanë nënshkruar të marrin masat që janë

më të përshtatshme dhe më favorizuese për fëmijët. Në botë ka shumë instrumente që mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Dokumenti më kryesor që lidhet drejtpërdrejt me fëmijët është “Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, puzzle të së cilës i gjeni kudo në këtë broshurë.

Një nga aktet e para ndërkombëtare të firmosura nga Shqipëria pas rënies së sistemit komunist është *Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës*. Ky dokument ka të bëjë me gëzimin të drejtave të fëmijës dhe detyrimet e shtetit tonë për t’i realizuar këto të drejta lidhur me kushtet që duhet t’ju plotësohen fëmijëve aspektet ekonomike, sociale, ligjore dhe institucionale. Nga viti 1992 vendi ynë u angazhua që të mbrojë të drejtat e fëmijëve sipas standardeve të kësaj konvente. Ajo mbështetet në katër parime kryesore:

- i. Mos diskriminimi
- ii. Përkushtimi ndaj interesave më të mira të fëmijës,
- iii. E drejta për jetën
- iv. Mbijetesa dhe zhvillimi.

Përveç saj, një sërë instrumentesh të tjerë po i rendisim më poshtë:

- ❖ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- ❖ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
- ❖ Karta Sociale e të Drejtave të Njeriut

Të gjitha këto konventa vihen në zbatim përmes institucioneve ndërkombëtare si:

- ❖ Organizata e Kombeve të Bashkuara;
- ❖ Komiteti i të Drejtave të Fëmijëve
- ❖ Këshilli i Evropës
- ❖ Bashkimi Evropian
- ❖ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
- ❖ Organizata të shoqërisë civile si UNICEF, Save the Children, World Vision etj.

Të gjitha organizmat që listuam më sipër, vendase dhe të huaja janë gardianët e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe fëmijëve në veçanti. Ato ndihmojnë në parandalimin e konflikteve, në zhvillimin dhe përmirësimin e demokracive, ndajnë vlerat e përbashkëta dhe rrisin frymën e bashkëpunimit mes vendeve.

Pra, gjithë këto mekanizma dhe instrumente ti mund ti përdorësh dhe të kërkohsh që të drejtat e tua të respektohen ose vihen në vend nëse janë shkelur. Ti ke mundësi që të mund të paraqesësh ankesa/kërkesa pranë, Drejtorit të Shkollës, Psikologut, Bashkisë, Policisë së Shtetit, Institucioneve përgjegjëse për fëmijët, Ministrisë, gjykatës etj.

Nëse ty nuk të është dhënë e drejta në vendin tënd ti mund ti paraqesësh kërkesë, Komitetit të të Drejtave të Fëmijëve apo Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). P.sh. ka pasur disa raste kur gjykata ka vërtetuar se një shtet ka shkelur Konventën pasi kishte diskriminuar për shkak të pakicës etnike një grup fëmijësh duke i vendosur të gjithë në një klasë dhe ndarë nga pjesa tjetër e shokëve. Gjithashtu edhe në shtete të tjera janë vërejtur shkelje ku fëmijët kanë udhëtuar të pashoqëruar nga të rritur ose dhe raste kur fëmijët mund të jenë vendosur në të njëjtin ambient ndalimi me të rriturit.

Në rast se të drejtat dhe liritë e tua nuk respektohen ti tashmë je në gjendje të marrësh disa masa. Gjithë sa thamë më sipër duhet mbajtur vesh në vesh në mënyrë që ti të luash rolin tënd siç duhet. Ti tashmë njeh të drejtat e tua, di si të sillesh dhe kujt ti drejtohesh.

4.2 TI KE TË GJITHA MUNDËSITË PËR TË MBROJTUR VETEN TËNDE DHE SHOKËT

Për të përfunduar me sukses puzzle, ne na mbetet të themi vetëm disa këshilla të fundit, në rast se keni dyshime që të drejtat dhe liritë tuaja janë duke u shkelur:

- ❖ Do të ishte e udhës të flisje dhe komunikojë me njerëz që i beson, siç mund të jenë prindërit, mësuesi kujdestar, psikologu, një kushëri/kushërirë më e madhe, njerëzit që kujdesen për ty;
- ❖ Mund të kontaktosh në numrat që vihen në dispozicion për fëmijët që janë viktime të dhunës;
- ❖ Të shkosh në polici dhe të bësh ankesë ndaj kujtdo që mund të të ketë dëmtuar;
- ❖ Të paraqesësh rastin tënd institucioneve përgjegjëse që ndodhen pranë bashkisë, si psh. Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës;
- ❖ Të paraqitesh në organizata që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe ato mund të të ndihmojnë për të paraqitur rastin në Gjykatë.

Ky ishte gjithë rrugëtimi që shpresojmë ta keni shijuar në mënyrën tuaj. Çdo gjë që mësuat mendojeni si një puzzle imagjinar në mendjen tuaj. Në rast se puzzle-i juaj ka të gjitha formueset në vendin e tyre atëherë ju nesër mund të jeni një ambasador për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në rast se ndonjë nga formueset nuk është në vendin e duhur t'i duhet të përpiqesh pak më shumë. Me vullnet edhe punë mund të arrish të bëhesh çfarë të dëshirosh. Edhe diçka të fundit, nisni dhe projekttoni veten tuaj ku do të jeni në vitin 2030. Imagjinata nuk ka kufij, sidomos ajo e një fëmije.

BIBLIOGRAFI

Akte Normative Ndërkombëtare

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 1948

Karta Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2000

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 1950

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, 1989

Akte normative Kombëtare

Kushtetuta e Republikës së Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, miratuar me referendum më 22.1.1998, shpallur me dekret të Presidentit të Republikës me nr. 2260, datë 28.1.1998 të Kuvendit Popullor, ndryshuar së fundmi me ligjin nr. 76/2016 nr. Datë 22.07.2016.

Ligji nr. 7531, datë 11.12.1991, "Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve"

Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"

Ligji nr.8417, datë 21.10.1998 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 28/1998

Urdhri Nr. 31, datë 28.01.2020 i Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore para universitare në Republikën e Shqipërisë"



Tekste/ Artikuj

Faskaj, A & Kalaja, E (2008), Pjesëmarrja e Fëmijëve në Legjislacionin Shqiptar, Revista 1

Amnesty International (2000), Our World, Our Rights

UNICEF, Stand up for Children Rights

Materiale nga Interneti

http://www.dei.ch/f/historique_droits_enfant.php

<https://bice.org/en/history-rights-child/>

<https://childrightshub.org/en/history/>

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804734f5>

<https://www.living-democracy.al/textbooks/volume-5/part-3/documents-and-teaching-material-2/>

<https://www.unicef.org/child-rights-convention/history-child-rights>

